

VENDIM
Nr.134, datë 1.7.2004

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË PËRBASHKËTA TË OSBE/ODIHR-IT DHE KOMISIONIT TË
VENECIAS PËR PËRMIRËSIMIN E KODIT ZGJEDHOR**

Në mbështetje të nenit 77 pikat 1, 2 e 3 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30, 88 dhe 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijohet Komisioni Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias të datës 23 prill 2004 mbi Kodin Zgjedhor.

II. Komisioni Parlamentar përbëhet nga 16 anëtarë, mbi bazën e barazisë pozitive-opozitive, nga të cilët 8 anëtarë janë përfaqësues të pozitës dhe 8 anëtarë janë përfaqësues të opozitës. Nga gjiri i vet, Komisioni zgjedh, me mirëkuptim midis grupeve parlamentare, dy bashkëkryetarë dhe sekretarin.

III. Komisioni Parlamentar do të fillojë nga veprimtaria e tij në datën e miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi dhe do të përfundojë brenda 2 muajve nga krijimi i tij.

IV. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash dhe quhen të miratuara kur votojnë "pro" përfaqësuesit e dy partive më të mëdha parlamentare.

V. Komisioni vepron sipas procedurës së përcaktuar për komisionet e përhershme në nenet 52 deri në 68 të Rregullores së Kuvendit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi